



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministrastvo Administracije lokalne Samopravo*  
*Ministry of lokal government Administration*

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-149, për Shërbyesit Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.02/2010 neni 15 paragrafi 2 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civi, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Shpall:

**KONKURS**

**I. Titulli i vendit të punës: Titulli i Vendit te punës:Zyrtar për Promovimin e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale**

Departamenti / Zyra:	Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave
Nr. i referencës:	MAPL
Grada e Vendit të punës:	9
Koeficienti:	7
Raporton:	Udhëheqësi i Divizionit për Integritime Evropiane
Lloji i Vendit të Punës:	Me orar të plotë
Mbikëqyrje e stafit:	0

**Detyrat dhe përgjegjësitë**

1. Të bashkërendoj punën që dokumentet strategjike të jenë në pajtim me politikat dhe prioritetet e Qeverisë dhe MAPL-së;
2. Bashkërendon politikat për zhvillimin e Planit Vjetor të Punës dhe dokumenteve tjera strategjike në përputhje me parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale;
3. Ndihmon strukturat tjera të ministrisë me udhëzime përkatëse për zbatimin e parimeve të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale;
4. Vlerëson kapacitetet e komunave për zbatimin e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale;
5. Bashkërendon veprimet me Divizionin për Ndërtim të Kapaciteteve për hartimin e planeve të trajnimit dhe organizimin e trajnimeve nga fusha e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale;
6. Bashkëpunon dhe ndihmon zyrën e komunikimit në MAPL, për çështjet e promovimit dhe afirmimit të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale;
7. Të përgatitë raporte periodike të punës;
8. Kryen edhe detyra tjera shtesë, sipas kërkesës së Udhëheqësit të Divizionit dhe Udhëheqësit të Departamentit.

### **Kualifikimet dhe Përvoja:**

- Diplomë universitare në Drejtësi, Ekonomi dhe Administratë Publike;
- Së paku 2 vite përvojë pune.
- Njohuri të përgjithshme të legjislacionit në Vetëqeverisje lokale, dhe njohuri të çështjeve të koordinimit të politikave;
- Njohje e gjuhëve zyrtare;
- Njohje e gjuhës angleze, e obliguar;
- Njohja e mirë e punës me kompjuter (aplikacionet Microsoft, internet etj).

### **Aktet ligjore dhe aktet nën -ligjore që rregullojnë rekrutimin**

Rekrutimin e nëpunësve civil e rregullon Ligji Nr. 03/L -149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullorja Nr.02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

### **Kohëzgjatja e emërmit**

Kohëzgjatja e emërimit-punësimit është në përputhje me LSHCK Nr.03/L -149, në të cilën është e përfshirë periudha e punës provuese njëvjeqare për një pozitë (1).

### **Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve**

Formularët zyrtarë për aplikim merren në Zyrën e Personelit të MAPL-së, Kati XII -zyra 1203, ndërtesa ish-Rilindja, gjithashtu mund të tërhiqen edhe nga web Faqja e MAPL -së.

### **Kushtet për pjesëmarrje në rekrutim**

Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjet e dëshmive për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat dhe Vërtetimin nga Gjykata që personi nuk është nën hetime etj..., mund të dorëzohen drejtpërdrejtë në Zyrën e Personelit të MAPL-së dhe përmes postës.

Aplikacionet e pranuar pas afatit të caktuar, konsiderohen të papranueshme nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar (postuar), para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve.

Aplikacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i plotësuar gabueshëm, do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk do të merret në konsiderim.

### **Procedura e Konkurrimit**

Procedura e konkurrimit është e jashtme dhe të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër/ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

Konkursi dhe kërkesa për punësim janë të publikuara edhe në ueb-Faqen e Ministrisë:

<http://mapl.rks-gov.net>

*Për informata shtesë mund të kontaktoni Zyrën e Personelit të MAPL-së, në telefonin: 038-200 35-511*